

Dramë në fillim të jetës

Ajo ndeu një si shpuarje thike, pak me dhëmbje e pak të ëmbël, që nisi nga hija e majtë dhe duke përshkuar mezin, nuk u sos dot në të djathtën. Kur thika mbaroj sëmbimin e saj, ajo la pjatën që kishte në dorë gjysmë të fshirë dhe u ul mbi divan. Vuri njëren dorë te mezi, tjetren përmbi barkun plotësisht të rrumbullakosur dhe e kuptoj që do të lindte.

Si të gjitha gjërat që bën për herë të parë, të cilat kanë fshehtësinë e tyre, edhe lindja ka të fshehtat e të papriturat e saj, të cilat nganjëherë kushtojnë shumë shtrenjtë, por që Merita asnjëherë nuk i kishte shkuar në mendje, qoftë vështirësitë e aq më pak të papriturat. Ajo e donte atë fëmijë e për ta rritur brenda qenies së saj e për ta sjellë në jetë nuk kishte sakrifikuar pak. Kishte lënë prapa, dashurinë e saj, njerëzit, kujtimet, vendin dhe udhëtoj për në atë qytet të huaj, që fëmija i saj të jetonte. Gjeti punë të një plakë, që goditi grua e mirë e kishte vuajtur shumë në jetë. Rroga që merrte ishte vërtet simbolike, por ajo kishte shumë pretendime. I vetmi merak ishte fëmija, që zhvillohej në qënien e saj. Kujdesin që tregonte Merita në fillim, që ndryshimi i barkut të binte në sy sa më vonë, plaka e mirë e vuri re.

"Kush e di si do ta ketë hallin kjo vajzë e shkretë nga vendi fqinjë", - mendoj, por për të pyetur e shtynte më sot e më nesër sepse nuk donte që ta lëndonte. Edhe Merita donte t'ia thoshte të vërtetën plakës, por kush e di si do ta priste. Në rastin më të keq, se ajo nuk mund të fshihej shumë, mendonte të zinte diku një shtëpi me era me ato pak kursime që kishte mbledhur sa ta lindte fëmijën, pastaj, . . . pastaj si të gjithë të tjerët në këtë botë.

Një mëngjes, teksa pinin kafënë, plaka, kur Merita nuk e priste, i tha :

-Mos e fshih më barkun, Maria, - kështu i fliste plaka.

-Kurrë shtatzënia për një grua nuk është turp, përkundrazi. Ajo nuk rriti ta çonte filxhanin në gojë, u skuq e tëra deri në thua, hodhi sytë nga gruaja e moshuar dhe lotët nuk i mbajti dot. Gruaja i afroj kokën në gjirin saj të rreshkur dhe duke i vënë buzët në flokët e mëndafshhtë e la të ngopej së qari. Merita i kishte thënë plakës që ishte ishte jetime dhe që ishte rritur në një shtëpi fëmijësh, por mënyra e sjelljes së saj, e bërjes së punëve në shtëpi, e të folurit e të tjera, nuk e kishin bindur plotësisht plakën.

"Epo dhe mundet, -mendonte, -thonë që në atë vend shkollat kanë qenë të mira dhe pse varfëria ka qenë e madhe ". E tani që plaka e dinte sekretin nuk kishte më kuptim të fshihej. Dhe plaka nuk e meritonte këtë ishte lidhur shumë me vajzën e huaj, aq sa dhe kur ajo dilte në pazar për të psonisur, nuk e linte vetëm, por merrte shkopin e vinte bashke me të. Një djalë kishte plaka, që para shumë vitesh, kishte ikur në kurbet, në Australi e atje ishte martuar me një vendase. Pasi ishte martuar, i ishte lutur nënës ta merrte në atë vendin e largët, por plaka as kishte vajtur e as do të vente kurrë. Djali me nusen e fëmijët vinin shumë rrallë ta vizitonin e tani asaj, me Meritën, i dukej sikur e kishte shtëpinë plot.

-Nuk jam jetime,- nisi Merita të tregonte, - por ngjarjet në familjen time, ashtu rrodhën këto kohët e fundit. Atë verë kishin vajtur, pasi kishte mbaruar maturën, për pushime te njerëzit e nënës, që banonin në një qytet të madh të Shqipërisë së mesme. E të parët që i vënë re miket e reja nëpër familjet vendase, janë djemtë e lagjes, por ata kishin dhe një arsye tjetër më shumë që vinin rrotull pallatit ku rrinin dajat e Meritës. Aty jetonte bukura Adela, teza e Meritës, që ishte veç dy tre vjeçe më e madhe se ajo. Çapkënia Adela, që me sytë blu e vështrimin e hazdisur, dinte të tërbonte kë s'tërbohej e të varroste kë s'varosej, do të hynte në jetën e Meritës, si një uragan, që shkatërron gjithçka që i del përpara, pa e vuarë mendjen hiç se ç'plagë e dhimbje shkakton. Dhe veç kur ka bërë dermën, kthen vështrimin prapa ndërsa thotë "pse e bëra?", përgjigjet po vetë pa asnjë ndjenjë përgjegjësie. "E bëra". Dhe jo vetëm aq, por projekton dhe xhade të re për të ardhmen. Tip seksi e me koncept fluturë për t'u përkëledhur me të gjitha lulet që ka lëndina,

Adela do të hynte në jetën e mbesës së saj, jo si nje ëndërr, që vjen në gjumë e ikën bashkë me mëngjesin, por si nje hithër e njomë që sa herë e kujton ngacmimin e saj, të skuqet e të djeg gjithë trupi. Merita mori dorën e plakës në duart e saj e duke fërkuar lehtë damarët e dalë jashtë nga pleqëria, vazhdoi të tregonte gjithçka kishte ndodhur. Herë-herë, ndërpriste tregimin, merrte frymë thellë, afronte ngjarjet në kohë në kujtesën e saj dhe niste përsëri. Mbrëmja e asaj dite në qytetin fushor, sikur ndryshoi pak nga të tjerat. Kishte rreth një javë që kishte rënë një vape e zagushi e madhe dhe qyteti dukej sikur mezi merrte frymë. Mushkëritë e stërmëdha të tij, dukej se po thaheshin ngadalë dhe njerëzit e ngrinin kokën nga qielli se mos u zinte syri horizonteve ndonjë re. E si për të mirë të tyre, atë pasdite filloi të frynte një fllad i lehtë nga deti. Perdet e dyerve e të dritareve filluan të tundeshin ngadalë si të zgjuara nga një gjumë i gjatë e i rëndë. Nga korentet e ajrit, dyert e dritaret filluan të përplaseshin, por banorët nuk nxituan që t'i mbyllnin sikur të kishin frikë se mos trembnin flladin e meziardhur e ai largohej për t'u kthyer kushedi kur, ndaj dolën në bulevardin e lulishte për të marr brenda gjirit sa më shumë nga ajo dhuratë e papritur. Merita me Adelën u ulen në klub-lulishten e lagjes, që ishte mbushur plot e klientët duke kthyer shishet e ftohta të birrës, bisedonin e qeshnin me njëri-tjetrin, pa harruar t'i gëzoheshin flladit të freskët. Kur erdhi kamerieri, Adela i tha Meritës:

-Edhe ne birrë do pimë, - dhe pa pritur përgjigje porositi dy birra.

Pas pak, nga tavolina ngjitur ku ishin ulur dy djem të rinj, si dhe ato, dëgjuan:

-Ej flori! Paske miq. Adela, që e njihte mirë djaloshin, ia ktheu:

-Nuk qënka keq dhe lagja juaj, -Dhe duke bërë shenjë nga djaloshi tjetër, qeshi me të qeshurën e saj, që dinte ku qëllonte e dinte ku sëmbonte. Djaloshi tjetër ktheu fytyrën nga ato, të veshur me një buzëqeshje përhëndetëse dhe, duke ulur pak kokën poshtë, u duk sikur bëri të gjitha prezantimet e rastit për veten e tij. Merita i ndoqi replikat e tyre, jo me ndonjë interes kushedi çë, por për etiketë e mirësjellje, buzëqeshi sa për tu bërë e pranishme.

-E bëjmë me letër me birë, -tha djaloshi. -Ose vijmë ne me ju, ose hajdeni ju te ne.

-Jo, - tha Adela. -Nuk kemi aq shumë xhep.

-Po mirë, - pranoi djaloshi, -xhepi ynë, lëvizja juaja.

Pa pritur reagimin e Meritës, Adela u ngrit, mori gotën e birrës dhe u drejtua për në tavolinën e tyre duke kapur dorën e Meritës si për ta tërhequr me vete. Merita u bind pa folur dhe u bë siç vendosi Adela. Biseda e tyre pas prezantimeve reciproke, rrodhi qetë e për tema të këndshme. Kur u ndanë me ta, Adela i tha Meritës duke e kapur nga krahu:

-Mbrëmje e bukur, por ai Besniku, m'u duk sikur u vu në siklet.

-E ç'siklet! - tha Merita. -Vetëm nëse ka patur ndonjë siklet me vetveten.

-Nuk u shpëton gjë syve të mi, - tha tezja, që Merita nuk e quajti kurrë teze, - i mbetën sytë te ti

-Eh sytë atë punë kanë, - ia ktheu Adelës. -U duket sikur kullosin gjithë koriet dhe kur përmenden, shohin që kanë mbetur të uritur sepse nuk u ngulen në për t'u ngopur.

-Ta kam zili daljen nga situata, - i tha Adela.

-Në këtë rast nuk ka fare situatë e jo më dalje prej saj, - i tha Merita.

Ashtu hynë në shtëpi, ku thanë se kishin ngrënë dhe u shtrinë për të fjetur. E nesërmja ishte e nesërme dhe nuk dihej se ç'sillte. Merita u detyrua të ndërpriste kujtimet sepse thika, këtë herë më e fortë dhe më e zgjatur, e detyroi të kafshonte buzën e poshtme për t'i prerë rrugën ndonjë rënkimi. Kur ajo kaloi, u ngri ngadalë, mori çantën të bërë gati me gjithë ç'i duheshin, e la te dera dhe u ul në një stol, që iu ndodh pranë e mbështeti kokën te muri. Të nesërmen e asaj darke, sa doli nga shtëpia, Besniku, që kushedi se qëkur priste, pa shumë fjalë, i tha që ta shoqëronte. Ajo, disi e përkëledhur i tha se nuk do shkonte shumë largë dhe rrugën për atje e dinte, por ai nguli këmbë dhe asaj ia pati qejfi një shoqërim të tillë. Kështu që pranoi. Rrugës, kush më shumë e kush më pak, folën për njeri tjetrin. Secili mundohej të tregonte sa më shumë nga jeta e tij, secili mundohej të harronte sa më pak sa më pak nga ato që dëgjonte. Ai sa të mbaronte punën për ku ishte nisur e kur ajo doli u ulën në lokalin e parë që u doli përpara dhe porositën koka-kola. Dikur, Besniku vuri dorën e tij mbi të sajën, ndenji një hop ashtu dhe ngriti sytë drejt saj. Edhe ajo, pa dorën e tij mbi të sajën për një çast ngriti sytë drejt tij.

-Merita, -tha ai. -Mbrëmë mendova shumë. Nuk e di, por hera e parë që mendoj kaq shumë për një femër.

- Une, - i tha ajo pa ia hequr syrin nga syri, - nuk mendova fare ose më mirë, nuk kam menduar asnjëherë kaq pak për një mashkull.

- Më fal, - i tha ai. - Nuk desha të tregohesha gjahtar i madh sepse nuk jam në të vërtetë.

- As un nuk e mora për ashtu, - tha ajo dhe mori dorën e tij atje ku e kishte lënë dhe e vendosi ngadalë mbi dorën tjetër të tij.

- Dua të takohemi, - tha ai i bindur për veprimin që bëri Merita, - që të bisedojmë e të njihemi, po ne po bisedojmë, tha ajo.

-Drejt, -tha ai, po bisedojmë, por më shumë, më afër më. . .

- Oho, sa shpejt miqësohen njerëzit, dëgjuan dhe kthyen kokat instinktivisht të dy.

Adela duke buzëqeshur, shkoi drejt atyre tërhoqi karrigen bosh nga tavolina tjetër dhe duke u ulur vazhdoi:

- U habita kur kalova dhe u pashe këtu. Si je Besnik? Ku u bëtë bashkë kaq shpejt?

- Rastësia, u mundua të shpjegohej Besniku.

- Ah, sa faje merë mbi supe kjo rastësia tha, -tha Adela duke qeshur.

- Këtu nuk ka pse të akuzohet, tha Merita, - sepse nuk ka ndonjë faj për të marrë.

- E di, E di, - nxitij Adela, - po dhe shaka të mos bëjmë? Thika e tretë zgjati më e egër dhe më këmbëngulëse. Asaj i shpëtoi nga buza rënkimi dhe kapi fort me dorë ndenjësën ku ishte ulur duke shtrënguar dhëmbët deri në dhimbje. U kontraktua e tëra dhe u zgjat e mori telefonin. Formoi numrin e telefonit të spitalit dhe dha adresën e shtëpisë. U ngrit ngadalë, duke u mbajtur për muri dhe trokiti te dhoma e plakës Vangjeli.

- Erdha, tha ajo, që instinktivisht ndjeu atë që pritej. Nxitimi ndezi dritën e dhomës dhe sa u gjend përballë Meritës, bëri kryqin, mori një qiri dhe e ndezi duke iu lutur zotit që ta bënte lindjen më të lehtë. Iu afrua Meritës dhe i tha:

- Erdhi ora, moj bij. E pruri ai atje lart. E Ai di se ç'bën. Të marrim spitalin

- E mora, -tha Merita dhe e mbështolli në gji atë plakë aq të ëmbël.

- Mirë, mirë bëre, - tha plaka dhe u zgjat e e puthi në faqe. - mos ki merak, të tëra do të venë mirë. Dhe u vesh nxituar duke thënë me përkëdheli me vete, fjalë që Merita nuk i dëgjonte, por ndjente që i thoshte.

Ambulanca erdhi dhe ato u nisën, secila me vete në mendimet e tyre. Plaka Vangjeli thoshte: "Ndihmoje, o Zot!"

U takuan disa herë me Besnikun, deri sa një pasdite, ai e ftoi në shtëpinë e tij. Në fillim ajo nguli këmbë të mos vinte, por pastaj me këmbënguljen e tij, vajti....

Ai kishte mbaruar për inxhinieri pyjesh dhe shtëpia e tij ishte si një pyll i vogël, a si një shtëpi në pyll, këtë nuk pati kohë ta formulonte, ashtu si dhe tjetrën, që ra në duart e tij, apo ra ai në duart e saj.

Gjithçka rrodhi thjesht, pa shumë përpjekje nga të dyja anët, veç kur lakuriqësia e tyre i bindi se nuk kishte kthim mbrapa. Iu dhanë pa rezerva asaj bote, që veç kënaqësisë nuk njuh ndjenjë tjetër. Një botë e çuditshme. Gjithnjë e përsëritshme, asnjëherë e arritshme. Gjithnjë me enigmat e saj, që njeriu as mund t'i zbulojë, e as mund të njihet. Aq misterioze është kjo botë, saqë edhe pse je kthyer nga ajo dhe nuk të është mpirë akoma djersa e udhëtimit, kërkon të rinisesh përsëri të shtegtosh nëpër shtigjet e pafundme të saj.....

Dhe kjo për Meritën e Besnikun, zgjati disa kohë, derisa ajo u largua për në shtëpinë e saj.

Këto zhvillime të ngjarjeve, nuk i shpëtonin dot Adelës.

Sa erdhi radha e tregimit për atë, Merita rënkoi thellë. Plaka Vangjeli dhe infermierja në ambulancë, iu afruan pak shtratit portativ dhe pothuaj njëkohësisht shqiptuan fjalën "Durim"

Shqiptuan them unë, sepse ato e thanë në gjuhën e tyre; por edhe në atë gjuhë Merita e kuptonte.

Deshi t'u thoshte që nuk kishte lidhje me thikat e lindjes, por e la këtë mendim dhe u tret në kujtime.

Që të nesërmen e largimit të Meritës, Adela mori në telefon Besnikun.

-Jam Adela,- i tha. – Kam një porosi. Ku do të takohemi?

-Ku të duash, - tha Besniku, - veç pasdite.

Dhe takimi u bë atje ku vendosi Adela. Dhe ua thashë, që ajo varroste kë nuk varroseq....

Besniku u bë gjahu i preferuar i saj dhe gjahtarët për atë që preferojnë, lënë pa gjuajtur edhe gjahe të tjera, megjithëse janë më me interes, më fitimprurës.

Dhe pylli në shtëpi, a shtëpia në pyll, u bënë dëshmitarë të pagojë, të skenave të paimagjinuara.

Një trup, që jepej me gjithçka për hir të egoizmit femëror, dhe një trup tjetër, që shijonte gjithçka.

Kur Merita ndjeu shtatzaninë brenda saj, u pre e pothuaj u tjetërsua për një farë kohe. Fillimisht as i kishte shkuar në mendje se ajo do ndodhte, ndaj ishte hedhur në krahët e së panjohurës me gjithë ndjenjën e saj. Aq më shumë që kishte dhe të ashtuquajturën siguri të Besnikut. Ajo nuk i ishte futur thjesht një aventure të dalë ku të dalë.

Ishte e bindur që Besniku e dashuronte dhe ajo, jo vetëm që e mirëpriti dashurinë e tij, por e futi brenda gjirit të saj, për të hedhur rrënjë e për të lulëzuar.

Nuk kishin biseduar fare midis tyre për një martesë të mundshme, e jo më të bënin plane për një fëmijë. Ajo mendonte që fëmija është vërtetë një fryt i dashurisë dhe si i tillë hap horizonte të reja dashurore për një çift.

Ardhja e fëmijës mesa dukej kishte ndodhur dhe Merita u bind kur mjeku gjinekolog i tha se ishte shtatzënë.

I pari mendim që i erdhi, ishte të takohej e të bisedonte me Besnikun. Ajo i mendoi, por nuk i përfilli fjalët që do të qarkullonin për të. Ato fjalë, gjithnjë ishin thënë e asnjëherë nuk kishin mbaruar. Padyshim ato femra, që ishin bërë objekt i tyre, kishin historitë e tyre, dramën e tyre, gjithnjë me fund të njëjtë, diskriminimin, turpin.

Sepse e kishte gatuan kështu perëndia, që në një punë, që bëhet patjetër me dy vetë, ta mbajë përgjegjësinë vetëm njëri, ajo nuk e kuptonte por që nuk ishte mirë, nuk ishte.

Ndoshta një nga shkaqet, që shoqëria njerëzore kaloi nga matriarkati në pushtetin e burrave, ishte dhe ky i, mospërballimit seksual femëror nga burrat. Kur pushteti kaloi në duart e tyre, pushtetarët e rinj, padyshim që kanë menduar dhe për këtë pikë kaq me rëndësi për ta. Që atëherë do ta ketë fillesën, ndoshta, ngarkimi me turp i njërit, ose më saktë vetëm i femrës, nga fajtorët.

Dhe që atëherë, lumi i shekujve pothuajse nuk ka ndryshuar gjë, megjithatë mbi glob kanë ardhur e kanë ikur miliarda e miliarda banorë. Miliona e miliona pushtete kanë lulëzuar e kanë perënduar, male me ligje janë shkruar, por asnjë nga ata nuk e ndryshoi dot ligjin e pashkruar të fajësisë seksuale.

Por Merita nuk donte t'ia dinte për këtë. I vetmi vendim i saj, që ajo e quajti të drejtë dhe të domosdoshëm, ishte që Besniku ta merrte vesh që po bëhej baba. As që mendonte ndonjë kundërshtim të tij, përkundrazi asaj i dukej, edhe pse ishte larg me të, sikur ndiente gëzimin e tij dhe kjo e bënte me krahë për të fluturuar, larg fjalëve ogurzeza të fajësisë.

Ajo nuk dinte gjë se ç'kishte ndodhur midis Adelinës e Besnikut dhe nuk kishte si ta dinte. Në bisedat telefonike, megjithëse të rralla, ai nuk linte të kuptohej ndonjë gjë, po të mos kemi parasysh bisedën e fundit, kur ai i tha të bisedonin më rrallë në telefon, për arsye se puna e largonte nga qyteti. Merita e quajti këtë normale dhe, megjithëse pak qejfprishur, e pranoi propozimin e tij.

Në darkë, në shtëpi, ajo o tha nënës se do shkonte dy-tri ditë në qytetin e dajave. Nëna a pa në fytyrë. Seç kishte një përshtypje, që vajza kishte ndryshuar kohët e fundit. Dhe dukej sikur ishte shëndoshur pak, dhe dukej sikur ishte ëmbëlsuar në tipare. E ajo, të dyja, i lidhte me moshën, me vajzërinë e së bijës.

-Ç'që kjo vizitë tani? – i tha së bijës.

-Epo dy-tre ditë do të rri dhe do të kthehem, - i tha ajo.

Ato të dyja jetonin bashkë. Merita kishte dhe një motër tjetër, Suelën, e cila ishte e martuar dhe kishte një djalë, Ardin, që Merita e donte shumë dhe e kishte marrë malli, sepse ata bashkë me fëmijën kishin emigruar në Itali dhe për arsye dokumentash kishin rreth dy vjet pa ardhur.

Babai i Meritës kishte pesë-gjashtë vjet që kishte vdekur, ndaj nënë e bijë rrallë ndaheshin nga njëra-tjetra. Por këtë herë ishte ndryshe puna. Ajo duhej të udhëtonte për një çështje të rëndësishme, sa vetë jeta e saj. Me nënën do bisedonte pasi të kishte biseduar me Besnikun. Ishte e drejta e atij që ta merrte vesh i pari, që ajo do të bëhej nënë. Dhe padyshim që ajo do ta gëzonte shumë. Ky çast nuk ishte larg. E nesërmja ishte afër dhe nuk vonoi që të vinte.

Merita trokiti në shtëpinë e dajave dhe portën ia hapi Adela.

Ajo ngriu kur përballë saj pa Meritën. U skuq pothuajse e tëra dhe i mbeti habia në fytyrë. Nuk i kishte shkuar në mendje një takim i tillë. Në biseda Besniku i kishte thënë se i kishte prerë marrëdhëniet me Meritën, Por kjo vizitë e papritur diçka mbartte me vete, diçka që ajo në ato pak sekonda te dera nuk mund ta imagjinonte.

-E pse habitesh? – i tha Merita.- Unë jam.

-Ua, - u çlirua Adela. – Nuk e prisja, - dhe u përqaftuan me njëra-tjetrën.

Pas shkëmbimit të muhabeteve të rastit, Adelën nuk po e mbante vendi. Merita e vuri re këtë dhe pasi ktheu pak gotën me pije freskuese e la në tavolinë dhe i tha;

-Sikur diçka ke, mos nuk je mirë?

-Jo, jo, - nxitoi Adela, - mirë jam, por më duhet të iki se kam lënë një takim pune. Ja për këtë, - tha dhe hyri në dhomën e saj, nga ku doli e veshur, gati më të dalë.

- Më duhet të iki, - u tha, - nuk besoj se do të vonohem.

- Gjithnjë se era vjen e ikën, - i tha nënëdaja. – Nuk të mban shtëpia fare.

-Po punë moj mama, - nxitoi ajo dhe pasi tha një “mirupafshim” të shpejtë, doli nga shtëpia.

Adela zbriti shpejt e shpejt shkallët e pallatit dhe në kabinën e parë telefonike i telefoni Besnikut. Kur ai ngriti receptorin në krahun tjetër, ajo i derdhi me nxitim e frymëmarrje të shpejtuar togfjalëshin “duhet të takohemi tani menjëherë” Ai i shqetësuar i tha.

-Si është puna? Ç’ të ka ndodhur?

-Nuk është bisedë për telefon, - i tha Adela. – Të pres tani te lulishtja.

Të dy nxitonin për te vendi i takimit. Ai me padurim për të mësuar atë që kishte ndodhur, e që patjetër ishte e rëndësishme derisa Adela fliste aq e shqetësuar në telefon; ndërsa ajo me padurimin për t’i thënë për ardhjen e Meritës dhe për të marrë vesh nga ai se ç’do të bënin. U duk që planet e tyre për atë ditë u prishën.

-erdhi ajo, - i tha Adela menjëherë sa u takuan.

-Kush, ajo, - tha ai.

-Merita, kush tjetër, - tha Adela.

-Si kështu....papritur, - u pre ai në fytyrë.

-Papritur, papritur, ajo është në shtëpinë time, - i tha Adela.

-Po mirë, - e mblodhi veten ai. – Një ditë ajo do të vinte.

-Si do t’ia thuash? – i tha ajo. – Aman, për mua mos i thuaj gjë.

-Po për kë t’i them,- tha ai, - për Marikën?

-Jo, jo për mua, - uli pak kokën Adela. – Thuaji që bashkë nuk kemi gjë, por jo që jam unë në mesin tuaj.....

Në fund të fundit, më mirë le ta quajmë lidhjen tonë një rastësi, si një flirt të parëndësishëm, që tashmë ka kaluar.

-Kështu mendon ti? – i tha ai. – Këto nuk i menduam kur nisëm dhe unë e ndiej veten fajtor përpara Meritës, por tani është mirë ta çojmë deri në fund. Kështu është jeta. Jo gjithçka zhvillohet si duam ne. Dakord. Është lidhja midis ju të dyjave, por gjëra që ndodhin këto. Sado e rëndë, e vërteta një ditë do të mësohet, - vazhdoi ai. – Të them të drejtën, unë nuk dua të kthehem mbrapa. Do të plagoset Merita, aq më shumë që je ti ajo tjetra, por me kohë do ta kalojë. Unë e desha dhe tani më vjen keq për të, por duhet.

-Nuk e di, - tha ajo, - ndoshta është më mirë që të ndahemi bashkë.

-Ç’thua – i tha ai dhe e afroi pranë vetes. – Je kaq e bukur dhe unë të dua. A nuk do të veproje dhe ti kështu?

-Unë jam ndryshe,- tha ajo. – Pastaj akoma nuk kam vendosur të martohem me ty. Thjesht një

lidhje, një aventurë.

-Lëri këto, - tha ai. – Për mua është një aventurë, që do të zgjasë gjithë jetën.

Ata u ndanë dhe ai, duke marrë rrugën për në shtëpi, solli në mendje ditët që kishte kaluar me Meritën. Thellë ai vazhdonte akoma ta donte, por imazhi i asaj, që vdiste kë nuk vdiste nga sytë e saj, dukej sikur e largonte Meritën deri në harrim, deri në humbje.

Donte të përqendrohej rreth takimit me të, sepse ai takim do të bëhej në mos sonte, nesër, por ishte e pamundur ta bënte atë dhe ashtu trulodhur u fut në shtëpi. Nuk dinte ç'të bënte. Hapi bufenë e pijeve, mori një gotë dhe e mbushi me raki. E ktheu dhe ndjeu djegësirën e saj në grykë.

Mendoi si do ta priste Merita, atë që do t'i thoshte dhe prapë i erdhi keq, e prapë kuptoi se thellë në zemër e donte, e prapë imazhi blu.....

“Ndahemi”, kishte thënë Adela.

Ç'ishte kjo? Sakrificë për hir të Meritës, apo ajo vërtetë nuk ndiente gjë për të dhe kishte krijuar një lidhje sa për të kaluar kohën? Kur nuk ndiente gjë, përse ta kishte krijuar këtë lidhje pikërisht me atë, kur ajo e dinte që Merita e dashuronte? Për zili? Qyteti kishte plot djem dhe ajo dinte t'i bënte për vete, ashtu siç bëri dhe atë. Zili me Meritën? Po ajo ishte mbesa e saj dhe aq më shumë, ishte një tip, që vërtet e admiroje, por nuk të linte shteg për t'u bërë ziliqare. Egoizmi? Ky po, mund të ishte, por tani që ai kishte rënë plotësisht në grackën e saj, përse duhej të ishte i pranishëm? E nëse do të vazhdonte të jetonte në shpirtin e Adelës ky egoizëm, mos duhej ta ndërpriste lidhjen këtu?

Imazhi blu u shfaq prapë dhe si për t'ia hequr atë mendim, këtë herë buzëqeshte.

“Jo, - i tha vetes. – Ajo më do dhe kot tjerr mendime të tilla”

Në dhomën e pranimit në spital, Meritës i erdhën përsëri dhimbjet. Mjeku porositi të bëhej gati salla e lindjes ndërsa vendosi në krahun e pacientes, aparatit e tensionit. Teksa mjeku kontrollonte tensionin, infermierja, që filloi të mbushte aktin e pranimit, pyeti për emrin.

Merita kishte shtrënguar dhëmbët për të duruar dhimbjet, e në vend të saj u përgjigj plaka Vangjeli:

-Marie, - tha – Marie Goga.

Merita e quajti të panevojshme ndërhyrjen për korigjimin e emrit të saj.

“ Sa gjëra ndryshuan në jetën time, dhe kjo nuk ka se ç'të më bëjë”, - tha me vete.

Intervali i dhimbjeve ishte zvogëluar shumë dhe ajo pak kohë kishte për të menduar.

Besniku njohu trokitjen e veçantë të Meritës në derën e tij. Ajo nuk kishte dashur të merrte në telefon, sepse donte që të gjitha për atë, këtë mbrëmje, të ishin të papritura. Të papritura të bukura. Edhe ardhja e saj, edhe ardhja e fëmijës. Aq më shumë ardhja e tij. Besniku e humbi qetësinë e pakparakohëshme dhe u ngrit ngadalë për të përshkruar atë copë hapësirë deri te dera dhe e hapi atë.

Merita iu hodh në qafë dhe e mbuloi me të puthura. Me atë, të varur me duar në qafë, ai me njërin dorë shtyu derën dhe me tjetrën e përqafoi.

-Më ka marrë malli.....Të dua. Të dua!- cicëronte në fytyrën e tij ajo, por ai ishte kontraktuar komplet përpara asaj furie dashurie, që kishte shpërthyer në shtëpinë e tij.

Pas pak, duke ndjerë mosreagimin e tij, ajo i mori faqet e tij në duart e saj, largoi pak fytyrën aq sa ta shihte në sy mirë dhe e nguli vështirmin atje.

-Sikur nuk je mirë. Ç'ka ndodhur? – i tha

-Asgjë,por më erdhi e papritur, - gënjeu ai dhe u skuq pak. – Po ulu, ulu të bisedojmë.

Ajo u ul në divan dhe mori gotën e rakisë, që ishte në tavolinë, e vuri në buzë sa e provoi dhe e vuri përsëri atje.

-Diçka ke, por mua do të ma thuash. Kot nuk ke marrë gotën e rakisë, - i tha dhe ndërsa ai u ul pranë saj, ajo e përqafoi përsëri duke e puthur. – Të lutem ma thuaj, le të jetë çfarë të dojë. Nuk të shoh dot në këtë gjendje, të paktën sonte, - i përkëdheli flokët me gishtërinjtë e saj.

-Do të pish diçka, - i tha ai

-Çfarë, raki? – i tha ajo. I kamë lënë pijet alkolike, - qeshi.

-Diçka tjetër, - tha ai. – Duhet të bisedojmë..... të

Ajo prapë u përqendrua. Vërtet diçka kishte. Instiktivisht u përgatit për të dëgjuar diçka të rëndë, për të cilën kishte dyshuar që në fillim nga qëndrimi i Besnikut, por kurrë nuk i vinte mendja deri atje.

-Po fol, - i tha jo. – Më thuaj.

-Merita, - filloi ai të fliste pa e parë në sy, - Që kur ike ti diçka ka ndodhur. Diçka, që e kamë vështirë të ta them.

-Thuaje, - pëshpëriti ajo dhe përplasi qerpikët sikur diçka ndjeu. – Thuaje

-Midis nesh ka hyrë një tjetër, - tha ai dhe mezi i ngriti sytë.

-Si,si....tjetër. Si.... tjetër, - tha ajo dhe lotët nuk i mbajti dot. – Jo, mos e thuaj. Nuk është e vërtetë. Nuk është..... – u afrua tek ai. – Më thuaj që bën shaka, më thuaj, - ngriti paksa zërin.

-Nuk është shaka, - i tha ai, - nuk është.... – dhe thellë- thellë ndjeu një dhimbje, një dhimbje, që e bëri t'i dridhej buza

Ajo për mes lotëve, i kapi dorën. Diçka u ravijëzua në trurin e saj. Pritja e Adelës, ngrirja e saj, ikja e saj, mosardhja deri sa ajo u largua nga shtëpia dhe u zverdh, tundi kokën fort si për të larguar mendimin e keq dhe i tha:

-Cila është? Cila?

“O Zot, - lutej, - të mos jetë ajo. Të kem gabuar anë”.

-Cila? – iu drejtua atij.

Ai nuk foli. Nuk kishte ç'të thoshte. Nuk mund të fliste. Ç'të thoshte? Të mbronte poshtërsinë e tij dhe të asaj tjetrës? Po mbrohet poshtërsia? Si t'i thoshte kush ishte? Ajo nuk ishte një tjetër radhë. Ajo ishte dikush për Meritën. Vërtet një dikush, që nuk ia vlente, por ama ishte.

Përsëri dyshoi Merita. E kapi me dorë te mjekra, ia ngriti fytyrën lart, sa ai e pa në sy dhe nëpër mjegullirën e lotëve i tha.

-Ajo është, ë ? Ajo, thuaje.....fol.....fol....- dhe i ngrit nga divani. – Ajo është Adela,Adela!

Ai deshi të hiqte sytë, ajo ia ktheu përsëri. Ai prapë nuk foli, por edhe pa folur, i tha të gjitha.

-Jo. Ky nuk e meriton të jetë babai i fëmijës tim. Mendoj me vete “Më mirë pa baba fare, më mirë”.

-Kur filloi, - iu drejtua atij..

-Sa ike ti, - u mundua ai të shpjegohej.

Asaj iu errën sytë. Ngriti kraun dhe e qëllloi fort në faqen e tij, aq fort sa atij iu kthye koka në anën tjetër, por nuk reagoi fare. Ajo mori çantën e dorës dhe u drejtua për nga dera. E hapi, ktheu dhe njëherë kokën nga ai, që po e ndiqte pa folur dhe pa lëvizur fare, me një dorë në faqen e sapogoditur, pastaj doli jashtë, tërhoqi derën pas vetes dhe u largua.

Diku ndaloj, u mbështet në një mur dhe qau, qau që nuk jetoi dot atë ëndërr të bukur.

E vendosur hyri në shtëpinë e dajave. Sa e pa Adela, që sa kishte ardhur, u ngrit dhe kur vuri re fytyrën e saj në atë gjendje, nuk belbëzoi dot asnjë fjalë.

Merita iu drejtua, e vështroi në sy, shtrëngoi dhëmbët me urrejtje dhe e qëllloi me pëllëmbë.

Në atë kohë hyri nënëdaja dhe kur ia pa ashtu e habitur pyeti:

-Ç'patët? Ç'ishte kjo? – dhe vështronte sa nga e bija tek mbesa.

-Ta shpjegon kjo.... bukuroshja, - i tha e qetë Merita.

Hyri në dhomë, mori valixhen dhe kur doli te dera tha, duke iu drejtuar nënëdajës:

-Më vjen keq....., po nuk mundem, - dhe nuk vazhdoi dot nga lotët, por hapi derën dhe u largua për në hotel. Atë natë nuk fjeti fare dhe sa ra mëngjesi udhëtoi për në qytetin e saj. I gjykoi e i rigjykoi veprimet e saj dhe të të tjerëve gjatë atij njëzetekatërorëshi. Pastaj mendoi nënën. Do t'ia thoshte hapur të gjitha dhe ajo le ta gjykonte si të donte.

Problemi i shtatzanisë, doemos që ishte më i rëndi. I rëndë për çdo nënë, që vajza e saj ndodhet në gjendje të tillë. Por rrugë tjetër për Meritën nuk kishte. E dinte që nëna e saj për gjëra të tilla, nuk falte.

Grua e ndershme e me karakter të fort, ajo problemet e moralit i barazonte me jetën. Po ç'faj kishte dhe Merita. Dashuroi dhe ndodhi ajo që ndodhi. E megjithatë ajo e dinte pak a shumë

qëndrimin e nënës dhe i erdhi keq për të, për të dhe për vete.

Hapi derën e shtëpisë dhe sa hyri brenda, përqafoi nënën dhe e mbytën dënesat. E ëma po e pyeste se ç'kishte, por atë nuk e linin lotët të sqarohej. E ëma e mori për krahu dhe bashkë me të u ulën në divan. Kur ajo u qetësua disi, ia tregoi nënës të gjitha. Ajo dëgjonte pa folur dhe riprodhonte në trurin e saj, të gjitha skenat që i përshkruante e bija.

-Por duhet të të them, - vazhdoi vajza, - se jam shtatzënë.

-Si? – e ndërpreu e ëma.. – shtatzë... – dhe fytyra i ngriu, iu zbardh e iu zverdh, si fytyra e një të vdekuri.

-Po, nënë. Jam shtatzënë, - i tha e bija.

Nëna nuk reagonte. U ngri si një statujë. Një statujë e bërë në çast. Mezi hapi buzët dhe më shumë mendoi se sa shqiptoi:

-Dhe je gjallë, nuk je mbytur? Mbytu,mbytu!... – dhe i ra të fikët.

Merita e tundi fort, i ra lehtë një pëllëmbë në faqe, i thërriste “Mama, mama”,mori një gotë ujë dhe i spërkati fytyrën.

Kur u përmend, i fiksoi sytë te sytë e së bijës dhe prapë shqiptoi, a më mirë mërmëriste si në një të qarë me ligje nëpër buzë: “Turp, turp, mbytu, mbytu! O Zot, pse ia arrita kësaj dite?”

Merita u shqetësua shumë për gjendjen e saj dhe pothuajse nuk fliste fare për të kundërshtuar ndonjë gjë, vetëm përsëriste “Mirë,mirë” dhe aq. U ngrit dhe i bëri një kafe.

-Helm, helm me jep, - tha ajo kur i vuri filxhanin përpara. – Po si e bëre, moj, si e bëre, që u bëfsh lëmsh, siç u bëre. U-pu-pu. Jo, jo, nuk mund ta duroj këtë turp.

Nuk dinte ç'të bënte. Koka i gjëmonte. I dukej sikur që tani po dëgjonte thashethemet, ironitë, vështirmet përbuzëse.

-O Zot, - tha pastaj dhe shtrëngoi kokën fort me të dy duart. – Duhet ta dështosh patjetër atë fëmijë. Sa më shpejt, sa më shpejt. Po, po. Të vemi diku, të paguajmë. Nuk e duroj dot. – Iu afrua pak vajzës, i kapë dorën dhe iu përgjërua: - Po, po, ta dështosh. Që nesër, që nesër!.....

Merita nuk e kishte shkuar kurrë në mend një gjë të tillë. Dhe kurrë nuk do ta bënte. Ishte gati të duronte gjithçka, ishte gati ta linçonin, të bënin ç'të donin me të, por gjallë ajo kurrë nuk do ta vriste atë fëmijë. Jo! Ai kishte mbirë në trupin e saj dhe ajo do ta mbronte. Do ta mbronte deri në vdekje, nga kushdo.

-Kështu do të bëjmë, - nguli këmbë e ëma.

-Mama, - nisi të fliste e bija. – Nuk do ta bëj kurrë atë, kurrë.

Nëna e dinte, kur ajo thoshte një fjalë e mbante. Pa vështirimin e saj dhe e kuptoi që vendimi ishte i pakthyeshëm. Por edhe turpi ishte i pakthyeshëm. I dhëmbi para se ta shprehte, por e tha:

-Atëherë, bëji derman vetes. Bëj ç'të duash, por të turpëruar, nuk dua të të shoh gjallë mbi dhe. Dëgjovë. Dëgjovë! Thuaj.

Dhe Merita e dinte. Inatin e saj nuk ishte një e re, që shkarkohej e pastaj qetësohej. Jo. Ajo duronte gjithçka, veç turpit. Turpin, jo. Dhe vdekjen e pranonte. Është me mjaltë para turpit, thoshte, por turp, jo. Edhe dheu nuk e duron dot turpin. Edhe ai nuk tret të turpëruar.

-Dakord. Mirëpo, a është turp?

Të dashurosh, të kërkosh të jetosh jetën, që ta kanë dhënë, të hidhesh në krahët e saj, pa menduar se rreth teje ka njerëz, që duan të ta prishin atë, duan të ta nxijnë, duan të ta vrasin, turp është?

Jo. Nuk është turp. Turp është ta braktisësh jetën, të jesh i pazoti që ta jetosh atë, të humbasësh toruan në labirintet e saj e të dorëzohesh pa kushte, të mos dish të gjesh shtigjet për të dalë atje ku duhet,po të rropatesh monopatesh pa fund e krye e kur të shohësh që je ende tek ai shteg nga u nise, kur të tjerët kanë ikur shumë përpara, ky është turp. Ky është njësoj sikur të mos kesh ardhur fare në këtë botë.

Dhe pikërisht këtë turp nuk donte Merita. E dinte që do ta paguante shtrenjt, por do të vinte dita kur njerëzit do thoshnin, që është ajo, ajo që e jetoi jetën ashtu siç iu dha... Vërtet jeta i qëlloi e ashpër që në burbuqepsjen e saj, por ajo nuk la veten të notonte në turbullirat e kohës.

Dhe Merita do t'ia dilte mbanë. Aq i fuqishëm ishte ky vendim tek ajo saqë nuk linte vend për asnjë mëdyshje dhe lexuesi dalëngadalë po bindet për këtë, e në se e ndjek me vëmendje ngjarjen,

do t'i bëjë vetes pyetjen:

“Cili është turp?” – e nga përgjigja që do të japë, do të përcaktohet dhe mendimi i tij për nocionin turp.

Marrëdhëniet nënë-bijë erdhën gjithnjë duke u acaruar, secila në vendimin e saj. Nëna- dështim, e bija- jetë!

Kështu që Merita gjeti rastin e udhëtoi për në shtetin fqinjë. Me dhimbje, me lot, por duhej.

Në shtëpi la një copë letër me dy radhë shkrim.

“Mama, të dua shumë. Turpin po e marr me vete. Kur të ndjej që e kam larë, atëherë do bëhem e gjallë.

Atëherë, besojë se do më falësh. Merita”

E njoftuat burrin tuaj, të afërmit? – e përmendi mjeku.

-Doktor, - tha ajo – unë nuk kamë njeri.

-Nuk keni njeri? – u habit mjeku. – Po fëmija..

-Unë jam nëna e saj, - u hodh e tha plaka Vangjeli.- Unë do vijë në sallë. Mos ia vurrë re doktor, - dhe vuri dorën e rreshkur mbi buzët e Meritës.

Ajo e pa në sy dhe as loti, që vezulloi nuk e mjegulloi dot lotin e plakës.

Ishte më të gdhirë, kur plaka Vangjeli i vuri në duar të birin.

Merita hodhi vështrimin e ëmbël të nënës mbi fytyrën njomëzake të tij. Vuri ngadalë dorën në balin e tij, në faqet, në buzë dhe e përkëdheli lehtë, siç dinë të përkëdhelin nënat. Afroi buzët e saj te flokët e tij dhe aroma foshnjore e fëmijës, u fut thellë në qënien e saj.

“Sa erë e mirë, - mendoi.- Ermir do ta quaj”

-Ermiri i nënës, - e përkëdheli, - dhe buzët e saj puthën djalin në flokët e zinj. Një puthje shpirti, puthje jete, puthje e dëshiruar nga të gjithë, deri në vdekje, deri në varr, puthje mirëseardhjeje në këtë botë.

Plaka Vengjeli, i mori vesh përkëdheljet e nënës, se të gjitha nënat njëlloj përkëdhelin në botë, por nuk kishte si ta kuptonte emrin, me të cilin nëna pagëzoi të birin, ndaj e pyeti:

-Ke menduar për emrin?

-Tani sa i fola në emër, - i tha. – Ermir e ka emrin. Plaka nuk e formuloi dot atë emër. Në vendin e saj nuk kishte emra të tillë, ndaj kërkoi shpjegime. Merita ia përktheu në gjuhën e saj domethënien e atij emri dhe plaka e pranoi që ishte një emër shumë të bukur, megjithëse i vështirë për t'u thirrur nga ajo.

Të gjitha, deri në largimin e saj nga Shqipëria, i dinte merita dhe ia tregoi plakës Vengjeli atë mëngjes të kafesë. E që nga ajo ditë kishin kaluar shtatë- tetë muaj. Lidhjet e saj me botën e të afërmeve, ishin ndërprerë plotësisht, për hir të shenjtërisë së emrit nënë. E tani që kishte këtë emër kaq të shtrenjtë, malli për ta sa vinte shtohet.

E shkonte veten në sitën e gjykimit, por asnjëherë nuk e gjente të turpëruar, përkundrazi ndjehej krenare, që kishte një fëmijë, aq të bukur, e një dashurie të sinqertë, që edhe pse zhgënjyese, kishte mbjellë fidanin e saj, që duhej selitur me kujdesin më të madh.

.....Nëna e Meritës, sa hyri në shtëpi, gjeti letrën e vajzës në tavolinë, e lexoi, futi të dy duart në flokët e saj të thinjur dhe rënkoj thellë. Aq i thellë ishte ai rënkim sa dukej sikur delte nga në shpellë e madhe dhe mbartte me vete gjithë dhimbjen e dheut.

E dinte që vajza do bënte siç thoshte në letër, po ajo, ç'të bënte? Të hapte kuje, të hapte gjëmë, apo të thoshte të vërtetën? Të vërtetën? Atë, jo! Ajo e vërtetë kishte nga prapa atë fjalën aq të rëndë, aq të tmerrshme, aq përbindësh: Turp!

Trupi i drodh e flokët iu zbardhën m shumë kur e shqiptoi. Po ikja e vajzës nga shtëpia, a nuk ishte turp?

E nënëmjera. Plot vajza kishin ikur nga Shqipëria, e për shumë nga ato, ishin hapur fjalë që të gënjyera nga ata, që kishin shpurë jashtë vendit punonin në punëra të pista, por Merita, kishte besimin ajo, do të dinte të mos futej në ato ujëra. Jo! Ajo pranonte më mirë vdekje, se një punë të tillë, e ne dyzimin gjykues të nënës, fitonte gjithnjë mendimi, që Merita do ta bënte jetën ashtu siç duhej. A nuk kishte shkruar dhe në letër, kur të kem lar atë “turp”, do të bëhem e gjallë? Po

njerëzve, atyre ç't'u thoshte?

-Ah, moj bijë, ç'më bëre, - tha dhe mbështeti kokën mbi tryezë.

Ditët e netët përcillnin njëra – tjetrën, e ajo në secilën prej tare, më shumë zbardhej, më shumë rrëgjohej më shumë firohej. Aq shumë ndryshoi, sa erdhi e u bë si një hije, sa që njerëzit nuk guxonin t'i flisnin dot, se mos zhdukej e nuk shfaqej më. Ai njeri-hije mbante end vetëm fjalët e letrës” do të bëhem e gjallë” dhe flinte e ngrihej me ato fjalë. Flinte e ngrihej, them unë, se ajo as flinte e as ngrihej. Ajo fjetur e ngritur ishte gjithnjë.

Kohë me vonë, nëna e saj dhe e Adelës, nënëdaja e Meritës, i ra ziles së portës. E bërë merak për ndërprerjen e lidhjeve me të bijën, ajo mori rrugën vetë për ta takuar.

Kur e bija i hapi portën, pa përpara fantazmën e së bijës dhe jo atë që njihte ajo.

-O Zot, ç'është kështu? – tha dhe shkopi i ra nga dora. – Ç'ka bërë vaki, moj korbë? – mezi shqiptoi.

E bija u mbështet në krahët e saj dhe as qante, as fliste. I ishin tharë lotët, i ishte mekur zëri, i ishte pikur shpirti.

Ngadalë, pa folur, u drejtuan në sallon dhe atje nënëdaja, i mësoi të gjitha.

-Si kështu, moj bijë, - i tha,- shtatzënë? Po a e njeh babain e fëmijës! A bisedoi me të?

-Po,- i ta e bija,- por midis tyre hyri ime motër, Adela.

-Adela?! – u tromaks e ëma.

-Po, nënë, po, - thaja. – Adela jonë çapkënë, e bukura jonë, sybluja jonë.

-Jo, - tha e ëma, - nuk ka mundësi.

-Është shumë e vërtetë,- tha e bija.

Të ëmës iu kujtua pozicioni i hakërruar ku i gjeti, teze e mbesë dhe fjalët e Meritës “ ta shpjegon kjo”, ikja e Meritës atë mbrëmje nga shtëpia, ajo i kishte kërkuar Adelës të dinte ç'kishte ndodhur midis atyre të dyjave, por Adela ia kishte prerë shkurt “Nuk është punë për ty”, dhe ajo nuk e kishte zgjatur, duke menduar për një zënkë të zakonshme kalimtare midis tezes dhe mbesës, por kjo që mësoi tani, ishte hapu varr, të futem.

-Jo, - shqiptoi ngadalë, duke tundur kokën. – Deri këtu ,jo!

-Adela, e dinte që Merita ishte shtatzënë? – pyeti të bijën.

-Jo, - i tha e bija. – Vetëm ne të dyja e dinim. As ai, që nuk ia si as emrin, nuk e di, por ç'rëndësi ka. Është bukë e thyer ajo, është zemër e thyer. Nuk e imagjinoj dot si ndodhi ajo punë, por ndodhi dhe po e paguajmë shtrenjt, unë dhe Merita. Edhe ime bijë ka faj. Ku i kishte sytë, nuk është e vogël. Mirë iu bë! Ashtu le të mbetet dyerve të botës.

-Mos fol kështu, - i tha e ëma. – Ke ndonjë haber a ndonjë të dhënë, ku është?

-Jo, nuk kam asgjë. Me siguri diku punon. Sa për fëmijën, jam e bindur që do ta lindë. Pa e filluar jetën, e nisi me dramë.

Në anën tjetër, marrëdhëniet midis Besnikut e Adelës, kishin rrjedhurën shtratin e kohës, jo siç i donte ai, por siç i donte ajo. Njeri, që ngopet si gjinkalla me këngët e verës, ajo dalëngadalë, po gatuante brumin e helmuar të ndarjes.

Sytë blu, gjithnjë në kërkim, pangopësia aventurore, egoizmi në shkallën më të lartë, mbivlerësimi i vlerave të saj seksuale, nuk mund t'i duronte konturet e një lidhjeje të qëndrueshme. Dhe aq shpejt sa ishte ndezur ajo plakë, aq shpejt po fikej, madje për Adelën po bëhej e bezdisshme.

Ndryshe ndodhte me Besnikun. Ai nuk e donte një prishje të re, një rrokullisje të re. Ai e kishte të ngrohtë akoma pëllëmbën në faqe, që i dha Merita. Thellë në ndërgjegje e ndiente që e meritonte atë pëllëmbë, por për marrëdhëniet me Adelën, ndiente, një krisje brenda zemrës, që zmadhohej nga dita në ditë. Edhe pse mudohej ta pengonte këtë zmadhim me gjithfarë arsyesimesh, e çara e tij nuk pranonte me usta. E kur e pa, që ishte i pafuqishëm ta frenonte, vuri dorën në faqen e qëlluar dhe iu duk sikur në atë çast e mori atë pëllëmbë. Dhe i dogji shumë.

Aq shumë, sa përplasi kokën fort në tavolinë e i dolën lot nga sytë.

“Budalla, - i tha vetes, - Idiot! Si u katandise. Shkele me këmbë, jo vetëm jetën tënde, por edhe të asaj tjetrës. Turp! Ky është turp. E i turpëruar jam unë,” Vazhdoi.

-Ajo, kurrë. Ajo besoi dashurinë, unë e poshtërova. Ç'poshtërove? Kë poshtërova? Atë, jo! Vetën time poshtërova. U bëra lolo dhe vrava. Vrava një njeri. Një njeri, që më donte.

-Kërmill, - i tha vetes. – Zvarrisu tani pas syve blu. Kasollja, që ndërtova, nuk mbahet me furka. Ajo po shembet dhe nuk e ndalon dot shembjen e saj. Ajo po përçundohet, po varroset, po hirësohet.

Për Meritën, dinte vetëm, që ishte larguar nga Shqipëria.

“Po pse vallë iku, - mendoi. – Nuk ishte e para, që pësoi zhgënjim. Po e gjykoj, - vazhdoi. – Kush, unë! Akoma po e rëndoj? Nuk kam të drejtë. Ajo ka të drejtë, të drejtë, deri te zoti!”

Ndërkohë, nënëdaja, e kthyer në shtëpinë e saj, kërkoi Adelës me këmbëngulje të fliste.

- Fol, - i tha, - si është puna?

- Nuk ka ndonjë gjë për të ditur ti, - i tha Adela.

- Po për kë tjetër ka për të ditur? – u inatos e ëma.

- Thjesht, ishte një lidhje, që tani nuk më intereson më, - th Adela.

- Aq të interesoi, - iu kreshpërua e ëma, - sa nxive jetën e mbesës tënde, sa e le motrën tënde qyqe brenda katër mureve të shtëpisë, sa i vrave gëzimin e vetëm në jetë dhe i arratisë buzëqeshjen, shpresën? Aq?

- E nuk e mora kaq seriozisht, - tha Adela. – Le të mos bëjnë dhe ato kështu, sikur u bë qameti. Ka plot burra të tjerë.

- Po jot mbesë me atë është shtatzënë, - lotoi e ëma, - që ç'të të them. Mos e gëzofsh jetën, mos e gëzofsh,! – e mallkoi me gjithë shpirt.

- Këtë nuk e dija, - tha Adela. Epo dhe ti, mama, shumë ngul këmbë. Ka plot mënyra për të shpëtuar nga shtatzania.

- Po ajo nuk, nuk është si ti, moj delësheshë. – Ajo është si pika e pikës, ajo ka shpirt, ka zemër, moj... moj, - nuk vazhdoi dot e ëma.

- Secili e bën jetën si të dojë, - tha Adela. – Mua më pëlqen ta bëj kështu.

- T'u bëftë në grykë, - the ëma, - dhe mos t'u gjendte dermani.

- Ou, mama, - tha Adela. – Unë po dal, këtë punë ke ti.

- Mos ardhsh gjallë, o Zot! Mos e kthefsh kokën prapa. Të dhëntë perëndia një shuplakë, që mos të të shoh, e mos të të njoh njeri, që as mandatën tënde të mos tënde të mos më bien, se atë e mora që kur më llafosi jot motër. Dhe mëndatë më të madhe nuk ka. – Derdhi mallkimet e lotët e ëma, derisa Adela përplasi derën. Pastaj e lodhur nga gjithë ato fjalë, u ul në divan e filloi të qante me ligje Meritën,

- Ku je, moj e mira e nënës. Ku të ka hedhur fati, vallë? Të dhëmb shpirti, moj bijë, të ther zemra. E vetëm, udhëve të botës, si i ngrys ditët, si i gdhin netët? Po bëhu e gjallë, moj zemër, bëhu! Jo. Ti je e pafajshme, ti je engjëllorja e nënës. I moti vesh, nëna, i mori të gjitha, dhe iu këput shpirti. Bëhu, e gjallë, moj shpirt! – Dhe lotët nuk e prisnin njëri-tjetrin.

Adela, sa doli nga shtëpia, mori në telefon Besnikun dhe i tha prerë:

- Dëgjo, Besnik! Bashkë nuk kemi gjë. E shoh që karaktere tanë nuk përputhen. Vazhdimi i një lidhjeje të tillë, do të ishte i padurueshëm për mua. Dhe një fjalë tjetër do të të them, sa për ta ditur. Merita sapo mora vesh, është shtatzënë. – Dhe mbylli telefonin, pa i lënë kohë Besnikut të thoshte asnjë fjalë.

Dhe fluturoi. E lehtë nga trupi e pendë nga mendja, sytë blu të saj, nuk e vunë re fare fanarin e rrugës, dhe ndjeu vetëm goditjen vdekjeprurëse të makinës. Asgjë nuk pati kohë të mendonte truri i saj. Ora e jetës kishte ndaluar. Kalimtarët e shumtë, e shpunë trupin e saj në spital, por vetëm trupin; jeta kishte mbetur atje, tek ai bliri në anë të trotuarit.

Dikush vuri një lule tek ai vend, e pas tij dhjetra të tjerë, e bliri u rrethua me lule.

Dhe varrimi i saj u bë shumë i madh. Me lule e me lot. Qytetarët, të plagosur, kush më shumë e kush më pakë, nga i nëmuri kurbet, derdheshin valë-valë në varreza. E varrezat, si një lëndinë e bukur, që lulëzon dimër e verë, përcillnin heshtjen e lotët e vizitorëve, deri thellë në varre, atje ku dergjeshin të dhembshurit e tyre. Dhe ishin shtuar aq shumë varrezat, sa po merrnin përmasat e një qyteti të vogël në anë të qytetit të madh.

Edhe Besniku vajti në varreza. Hodhi një dorë dhe mbi arkivol. Lotët nuk e linin të shqiptonte asnjë fjalë. Dikush e kapi prej krahu dhe e ngriti në këmbë. Vetëm atëherë, ai tha me vete: “Pse, Adela, pse? Jeta jote sa kishte filluar. – dhe iku i heshtur nga varrezat, kur ato ishin boshatisur plotësisht, dhe vetëm varrimësi po vinte një tabelë llamarine te koka e varrit, ku ishin shkruar emri i saj.

Ditët pas lindjes, për Meritën, e kishin humbur qetësinë e tyre, Malli për nënën e të afërmit, për vendin e njerëzit e tij ushtronte një trysni të madhe nga brenda, sa vetëm refugjatët mund ta përshkruajnë. Por edhe ata, kur nisin ta përshkruajnë, u ngarkohen sytë si re më të shkarkuar dhe e ndërpresin aq shumë fjalën nga gulçimat, sa që bashkëbiseduesi i tyre, vetëm pëshpërit i habitur.

- Qenka shumë i madh, ai mall, më i madh nga deti, sa që gjiret njerëzore çuditen si e mbajnë.

- Po lidhu njëherë në telefon me të shtëpisë, - i tha Meritës, plaka Vangjeli, një natë. Edhe ata e kanë merakun për ty. Ti je kaq e mirë dhe fëmija po ashtu. Merita e dinte numrin e telefonit të shtëpisë, por me nënën nuk bisedonte dot, jo se nuk donte, por sepse nuk mundej. Motra e saj, Suela në Itali, kishte ndërruar vendbanim dhe nuk dinte ku ta kërkonte. Iu kujtua vjehrra e Suelës, një grua trime, tipike labe, sepse andej ishte, dhe iu afrua telefonit me foshnjën në dorë.

Plaka Vangjeli mori një cigare nga paketa, e ndezi dhe ndiqte lëvizjet e saj.

Merita ngriti receptorin mëdyzaj, formoi numrin dhe matan u dëgjua “Kush je?” ajo njohu zërin dhe nuk mund të fliste. Kaptonte gulçimat me dhëmbë të shtrënguar, ndërsa qerpikët nuk mund ta mbanin dot peshën e lotëve.

- Kush është? – U dëgjua përsëri matanë.

- Unë....- mezi belbëzoi. – Unë..... Merita

- Merita?!.....O Zot! Po ku je, moj bijë? Fol, fol, të të dëgjoj zërin. Fol, moj shpirt, fol, se nuk u besoj veshëve!

- Nuk....flasë....dot. dua telefonin e Suelës, - tha me intervale ofshamash të gjata.

- Ta jep nëna, moj e mirë. Shkruaje! – Dhe i dha numrin. Ndërkohë, foshnja qau dhe linja telefonike përcolli qarjen e tij.

- Ke lindur, moj bijë? Si linde, çfarë ke lindur, si është?

Dhe breshëria e pyetjeve nuk rreshte.

- Djalë. Dhe është i bukur e i mirë, - i tha.

- Si ti, të keqen nëna, si ti, - i tha vjehrra e Suelës. – do të vete vetë te nëna jote në qytetin tuaj. Do të vete, si nuk do të vete. Do t’i them që je mirë, t’u bëftë nëna.

Linja telefonike u ndërpre dhe Meritës i mbeti receptorin në dorë.

Pas pak ajo u lidh me Suelën në Itali, ku doli kunati, Berti, sepse ajo ishte në punë. Biseda e tyre u vërtit rreth ngjarjeve të shkuara, shëndetit, punës, mallit. Më shumë kohën e zuri biseda me nipin, për të cilin i dridhej buza, e veçanërisht interesimi i tij për bebin e vogël.

- Teze, thuaj të më flasë, - i tha ai.

- Po është i vogël, të keqen teza, - i tha ajo, - nuk flet dot, por të dëgjon. Kur të rritet edhe pak do të të përgjigjet.

- Po unë e dua shumë dhe dua ta shoh, - tha ai. – Edhe ty të dua shumë, teze.

- E di, shpirti i tezes, - e përkëdheli ajo, - edhe ne të duam shumë.

Plaka Vangjeli i ndoqi bisedat e saj duke thithur cigarin e duke ndjekur më nge udhët e lakuara që bënte tymi, që nxirrte nga goja. Ajo nuk e pyeti fare Meritën, por kur u ul, me vështrimin e syve, sikur ia tha të gjitha. Çehrja, që i kishte rënë në fytyrë fliste vetë, fliste hapur.

Në mbrëmje ajo çehre ndryshoi përsëri. Në telefon mori Suela dhe i tregoi gjithë ç’kishte ngjarë në Shqipëri pas largimit kësaj. Kur vajti te vdekja e Adelës, ajo me zë të dridhur i tha:

- Nuk besoj ta dish, por....Adela nuk është më.

- Si...si nuk është, çdo të thashme këtë? – i tha.

- Nuk është, nuk....jeton më; një aksident automobilistik – i tha Suela.

Ajo u prek. U rrëmbush në lot. Nuk e donte këtë, nuk e donte kurrë. Nuk kishte si ta donte. Ishte pothuaj një moshë me Adelën dhe i lidhnin shumë gjëra bashkë, jo vetëm gjaku. Vërtet që për hir të saj ajo ndodhej sot larg shtëpisë e të dashurve ta saj, por jo këtë, o vdekjen. Mendimi që Adela

nuk jetonte më, e tronditi, e mpiu.

Suela në anën tjetër po i thoshte të bënte kurajo, por ajo nuk mundej.

- Bëj durim, - i tha Suela, si dhe ne të tjerët. Edhe unë nuk isha në varrim, por më thanë që kishte vajtur gjithë qyteti.

- E mjera Adela, - ngashëroi Merita, - po e bën nusërin me vdekjen.

- Nuse, nuse e veshën, - i tha motra, - nuse, që u martua me vdekjen.

Suela i tregoi për rëndimin e gjendjes shëndetësore të nënës, pas gjithë atyre dallgëve, por e këshilloi të bisedonte ajo e para me nënën për Meritën, se mos i jepnin ndonjë goditje të re, që ajo nuk do ta mbante dot. Pastaj me të parë e të bërë.

Besniku kaloi një periudhë apatie. Ishte e nuk ishte. Fliste e nuk fliste. Dy goditje të mëdha shpirtërore, vdekjen e Adelës dhe qënien baba, ishte vështirë t'i kalonte aq lehtë. Në atë vorbull të padrejtimtë të mendimeve të tij, Ishte vështirë të gjeje rrugën e duhur, që të nxjerr në breg, sado notar i mirë të jesh. Dhe ai vinte re me keqardhje, që nuk e kishte drejtuar mirë anijen e jetës, por e kishte katandisur aq keq, sa qa tani, nga gjithë ajo bina e bukur e ndërtuar në ëndrra kaq vjeçare, i kishte mbetur mbi ujë vetëm një tra, që nuk dihej shpëtonte a nuk shpëtonte dot. E ai tra, që ishte shpresa e vetme për të korrigjuar diçka a ndoshta për të filluar nga e para, donte shumë sakrificë.

E nëse atij trari shpëtimtar, nuk ia hapje zemrën ashtu siç e kishte në të vërtetë, mund të zhytej thellë në det, sepse ai nuk kishte frikë nga mbytjet. Ishte mbytur e kishte dalë prapë në anë, jo vetëm se i ishte lutur Zotit e ai e kishte dëgjuar lutjen e tij, por sepse i kishte vlerësuar mbijetesën. E kur kërkon të mbijetosh, sakrificë është pak.

Dhe iu qep trari shpresëdhënëse, jo në emër të sakrificës, por në emër të mbijetesës. Tani e kishte qartë pse ishte larguar Merita. Ajo kishte linçuar veten, për ta lënë të lirë atë, që e donte aq shumë, të bënte jetën e tij me Adelën. Dhe jo pse ishte Adela ajo, por sepse ashtu do të bënte sikur në vend kësaj të ishte çdo vajzë tjetër.

Ajo e donte dashurinë, larg çdo ndjenje tjetër, që e cingriste sadopak. E në këtë betejë, ajo kishte fituar. Dhe kishte fituar pastër.

Me përpjekje të shumta, mori vesh nga njerëzit me të cilët kishte udhëtuar Merita, qytetin ku ishte vendosur ajo. Ai do ta gjente, sikur dhe në fud të dheut të zbriste, dhe në fund të qiellit të ngjitej.

Qyteti milionësh, ku u vendos, të habiste me madhësinë e tij. Ishte hera e parë që kalonte kufijtë dhe sa kishte mësuar ca fjalë nga një fjalor gjysmak, por duhej ta gjente Meritën.

E para t'i kërkonte falje: e dyta, të ishte pranë fëmijës së tij, gjaku të tij, jetës së tij: e treta, ta vinte zemrën e hapur, në tryezën e arsytimit të saj.

Kishte numrin e telefonit të një shokut të tij të fëminisë, Bashkimit. Ai e priti dhe e strehoi në shtëpinë e tij. Bashkimi punonte, si gjithë shqiptarët, në një eteri apo minindërmarrje, që merrej me lyerje ndërtesash. Iu lut afendikoit të tij që ta merrte edhe Besikun në punë e ai pas një dyzimi disaditor, e mori. Në atë eteri punonin dhe shumë shqiptarë të tjerë, që bëheshin rreth njëzet e pesë vetë. Të gjithë kurbetçinj, të gjithë hallexhinj.

Kishte edhe nga kombe të tjerë. Ukrainas, rusë, grekë, por më shumë ose më mirë, dy grupet kryesore përbëheshin nga polakë dhe shqiptarë.

Ishte krijuar një internacionalistët i qëndrueshëm dhe, duke krahasuar me eteri të tjera, ishte për ta patur në konsideratë.

Në mëngjes, kur pronari Sunjo, i hodhi sytë larushë Besnikut, ai e preu edhe frymëmarrjen, nga frika se mos nuk e merrte në punë. Vuri re që vështrimi i tij nuk ishte dashakeq. Sunjoja kishte punuar vetë si argat vite të tëra dhe i njihte që në sy njerëzit e punës. Mbi flokët dhe mjekrën e tij, bora e viteve kishte bërë punën e saj, dhe fytyra e tij kishte marrë pamjen e një portreti, aq shumë të lakmuar nga skulptorët.

Në pushimin e drekës, koha ishte e shkurtër dhe punëtorët nxitonin të hanin bukë që t'u mbetej kohë të pinin edhe ndonjë cigare.

Kështu bisedat ishin të pakta.

Kurse në pushimin e orës tre, se puna vazhdonte deri në orën pesë pasdite, kishte më shumë kohë për biseda dhe rriheshin të gjitha temat, që nga hallet e përditëshme e deri te politika.

- Dhe të njihemi, - iu drejtua Bashkimit, Kadriu, një burrë i urtë e dashamirës, që kishte vite që punonte në eteri. – Kush është zotëria?

- Më mirë të flasë vetë, - tha Bashkimi.

Dhe Besniku foli, jo për jetën e tij, por për atë që e kishte bërë të merrte udhën e kurbetit.

- Jam fajtor, vëllezër, - përfundoi ai, - deri në palcë, ndaj dua ta gjej, ndaj dua të më ndihmoni.

Të gjithë e dëgjuan historinë e tij të shkurtër, jo vetëm me vëmendje, por edhe të menduar.

- Po e kërkon vëlla, - e theu heshtjen Adriatiku, një djalë nga Tepelena. – Do ta gjesh. Se atë vajzë, me sa vura re unë, nuk e kërkon ti, por zemra jote. Dhe zemrat që duhen kanë komunikimin të çuditshëm. Sikur i japin sinjale njëra-tjetrës.

- Këtu, vërtet është qytet i madh, - tha Agustini, një djalë fjalëmbël nga Mirdita, - por bëj durim.

Të gjithë do të pyesim nëpër të afërmit tanë, që rrinë nëpër zona të ndryshme, po ti e para mos e humb punën. Është shumë e vështirë të gjesh punë këtu dhe ndërkohë të gjithë do të kërkojmë. Dhe unë them që do ta gjejmë, ose më mirë do ta gjesh.

Veri, një burrë rreth të pesëdhjetave nga Cërriku, duke ndjekur tërë bisedën, ndezi cigarin e dytë, ndërsa po vinte fundi i pushimit.

- More unë... – deshi të thoshte.

- Fol, - i tha Zabiti, një djalë nga Dibra, - thuaje!

- Mbase nuk është ajo, mbase nuk ka fare lidhje, - dyzoi ai kur pa që tërhoqi vëmendjen e të gjithëve. - Nuk e di. Kam një motër në Peristeri. Ka shumë vite që banon atje. Në një bisedë me gruan time, ajo tha:

“Nga gjuha nuk më duket greke. Mund të jetë nga kombet e tjerë, por mua më duket shqiptare. Nuk kam marrë guximin ta pyes. Duket vajzë e mirë dhe jeton me një plakë greke. Plaka nuk ka njeri këtu, por tani që vajza ka lindur e ruan me aq fanatizëm, si shqiponja që ruan folenë e saj. – Përse e ke fjalën? – e pyeta unë.

- Nuk të duhet ty, - më tha, - punë grash, - dhe iu drejtua prapë gruas sime: Ama është goxha vajzë.

Këtë desha të thosha, - tha Veri, - kushedi, mor bir....

Besniku i ndoqi me shumë vëmendje ato që tha Veri. – Ah sikur, o Zot, - tha

- Unë them, - vazhdoi Veri, - që të shtunën në darkë, Besniku të vijë te unë. Do të marr dhe motrën dhe e bëjmë me nge këtë muhabet.

Të gjithë ishin të atij mendimi, dhe Besniku edhe pse ndjente kujdesin dhe dashurinë e atyre njerëzve të mirë, mezi i shtyu ato dy ditë.

Shtëpia e Verit ishte një shtëpi e bollshme. Të gjithë shqiptarët, që jetojnë me familje në Greqi, shtëpisë vënë një rëndësi të veçantë. Dhe kjo është në traditë të vendit të tyre. Shtëpia nuk është vetëm e të zotit të saj, por edhe e mikut, dhe e vëllait, dhe e shokut, dhe e hallexhiut, që e zë nata në rrugë. Dera e hapur, pa le të jetë vetëm buka e kripa në vatër. Se kur hap derën e shtëpisë njeriu, hap zemrën dhe zemra e hapur është silur të ta japësh atë në dorë dhe të kesh të drejtën të vendosësh të rrahë apo të mos rrahë më.

Motra e Verit i kërkoj Besnikut karakteristikat e vajzës dhe nga përshkrimi që i bëri ai, vetëm flokët ndryshonin, nga të verdhë, të zinjë.

- Pse vrisni mendjen për flokët, - tha Veri, - pak bojë ka nëpër supermarkete?

- Drejt, - tha Besniku, - mund të jetë edhe ajo.

Të nesërmen Veri, Besniku dhe motra e Verit, morën urbanin për në Peristeri.

Ajo është një lagje e bukur e Athinës, si të gjitha lagjet e saj, por askush prej tyre nuk kishte nge ta admironte, e aq më pak Besniku. Mendimi që mund të mos ishte ajo, do ta hidhëronte, por dhe do t'i shtonte forcat për ta kërkuar më shumë.

Kur arritën në shtëpinë e motrës së Verit, burri i saj, duke e ditur se ç'ndodhte, pasi u serviri pijet, ashtu ngadalë tha:

- duhet të mos nxitohemi, - duke futur dhe veten brenda, - ta bëjmë punën të pjekur, Nuk jemi të

sigurtë, është apo nuk është ajo. Mirë është të bisedojmë me plakën Vangjeli njëherë, dhe këtë e bën mirë ime shoqe. Plaka del çdo pasdite në plati, kurse vajza qëkur ka lindur, del me fëmijën vetëm kur është kohë e mirë.

- Ashtu bëjmë, - tha Besniku, - megjithëse mesa shoh unë për mua mbetet pak punë. Nuk di si t'ju falënderoj, nuk di ç't'ju them.

- Asgjë mos thuaj, - i tha Veri. – Pi birrën e rri rehat. Thuaj vetëm, qoftë ajo!

Dritat e qyteti u ndezën pothuaj të gjitha njëherësh. Qytet i bukur për ata, që e jetojnë, qytet enigmash, për ata që e shohin për herë të parë. Qytet ku janë të papranishëm të mirat e të këqijat e njerëzimit. Qytet ku fliten të gjitha gjuhët e kontinenteve, qyte ku nuk mungon përfaqësimi i gjithë shteteve. Gjigand brenda Ballkanit, mban brenda gjirit moralin dhe krimin. I lakmueshëm për bukurit e tij, i pa tjetërsueshëm për historinë e lashtësisë së tij.

Por plakës Vangjeli as që i vinte mendja për këto që shkruaj unë. Ajo soli në platinë para pallatit dhe nga që nuk gjeti vend në stolin e zakonshëm të saj, u ul në një stol tjetër aty afër, duke mbështetur shkopin në syprinën e tij.

Motra e Verit, sa e pa që doli, u nis për te plaka. Ajo nuk duhej të çfaqej hapur që interesohej për Marien. Kur iu afrua stolit ku ishte ulur plaka, përshëndeti në gjuhën e plakës.

- Mirëmbërëma.

- Mirëmbërëma,bija ime, - iu përgjigj plaka.

Motra e Verit e përdrodhi disa herë muhabetin rreth Maries, aqsa plaka Vangjeli i tha:

- Shumë interesohesh për time bijë..

- Më fal, - i tha ajo, - por sepse dikë më kujton.

- Me sa di unë, familja ime nuk ka ndonjë lidhje me Shqipërinë, - iu kthye plaka, - ndaj nuk ka kë të të kujtojë. Po njerëzit, Zoti i ka bërë të tërë, ndaj dhe mund të ngjajnë. Interesimin e shqiptares, plaka nuk e hodhi pas krahëve. Ajo e dinte gjithë dramën e Maries dhe mendja i thoshte, që dikur dikush do ta kërkonte e ai dikush doemos që do të ishte nga ata që e donte sepse nga ata që t'i bënin keq, Maria nuk kishte.

Ndaj ashtu qetë hapi një dritare, a më mirë një pazar më shumë për të blerë, sesa për të shitur.

- Vajza ime është rritur në Australi, - tha ajo, - ndaj nuk flet mirë greqisht. Halle është bota dhe hallet mbarojnë kur vdes njeriu. Atje deshi një djalë dhe ai e tradhtoi. E ajo nuk e fal tradhtinë.

- si shqiptarët, - tha motra e Verit.

- Po ballkanas jemi, - tha plaka, - gjitonë jemi, të përafërta zakonet i kemi.

- Nënë Vangjeli, - iu drejtua motra e Verit. – Nuk e di por seç më thotë këtu brenda, - dhe tregoi vendin e zemrës së saj, - që ai njeri i mirë diçka fsheh. E unë them që nga kjo fshehje, edhe ti di diçka.

- Më ler, moj shqiptare, ta shijoj këtë mbrëmje të bukur, - tha plaka.

- E mirë,mirë, - i tha shqiptarja. – Me ty fola. Kisha diçka dhe ta thashë. Keq është.

- Jo,jo, - tha plaka, - është mirë kur e thua

- Domethënë....- tha shqiptarja.

Plaka e pa thellë në sy. Nuk ishte bisedë platie kjo.

Nuk ishte të shtyjmë kohën. E duke e lënë plakën në mëdyshjen e saj, shqiptarja u largua duke lëshuar një "Natën e mirë" të shpejtë.

Të gjithë bisedën, e ndjekur nga kurioziteti i burrave, motra e Verit e riprodhoi në shtëpi.

Për të gjithë kishte dy variante. Ose plaka kishte shtyrë kohën me shqiptaren, ose shqiptarja nuk e kishte ndërtuar mirë rrjetën e saj. Veç në të dy rastet një gjë qëndronte. Dyshimi. Plaka dyshonte te shqiptarja t'i hapej, shqiptarja dyshonte te plaka se nuk i thoshte të vërtetën. Por të një mendimi ishin të tërë, kur thoshin që çelsi ishte plaka.

Të nesërmen, kur plaka me njërin dorë tërhiqte karrocën e pazarit e me tjetrën ngulte shkopin trotuarit, Besniku dhe Tekiu, kunati i Verit, i dolën përpara. Tekiu e dinte mirë gjuhën e plakës, Besniku, aq sa i thoshte gjysmë fjalori. Tekiu i kërkoi plakës që ta ndihmonte.

- Avash, avash e kam, - ia ktheu plaka.

- Dhe ne më avash, avash se ti e kemi, - i tha Tekiu, duke përdorur në fjalë shumë të njohur në

gjuhë e saj.

- Ju, do psonisni? – i pyeti djemtë.

- Jo, - u ndodhën ngushtë ata.

- Nga jeni? – i pyeti prapë dhe ngriti sytë e saj kuriozë e vigjilentë.

- Nga Shqipëria, - i tha Tekiu.

- Andej nga është dhe Maria, - pëshpëriti plaka e Tekiu e kapi.

- Na thuaj, moj nënë, mos është Merita. Ky është Besniku.

Plaka ndaloi. E kishte dëgjuar emrin e tij shumë herë. Pa fytyrën e tij. Dhe i pëlqeu, pa shpirtin e tij, dhe e rrëmbeu, pa dridhjen e tij, e pa dhe e drithëroi, pa zjarrin e tij dhe e përvëloi.

Dhe ngriti shkopin lart. Plaka Vangjeli, mbështeti karrocën, me të cilën psoniste pas murit të pallatit, e pa fort e fort dhe iu zbut inati.

Kujtoi dashurinë e saj të parë, kur në një pritë për një fjalë, trimin e saj e kishin vrarë, dhe ajo lotët, që i derdheshin valë i fshinte, e ata bëheshin palë-palë.

E uli shkopin të çlodhte këmbën.

- Ti je Besniku? – iu drejtua ajo.

- Unë jam, - aprovoi ai dhe uli kokën.

Pastaj gjithçka rroshti natyrshëm. Tekiu foli për fillimin e plaka për vazhdimin e ngjarjes. Flisnin vetëm ata të sy, ndërsa Besniku as që merrte vesh se ç'po thoshnin. Fati i kishte shpurë atje ku duhej, te Merita, te biri i tij, te jeta.

Tekiu, që nuk falte udhë për katin e pestë, asnjëherë nuk kishte ngritur një peshë të tillë. Ai kishte parë dasma e gëzime, kishte parë vdekje e hidhërimi, por kurrë dy udhëtarë me një karrocë pazari ngarkuar me mendime dhe me ankth. Dhe kur ndaloi e ata zbritën, shkrifëroi supet, sikur të fillonte punë për herë të parë.

Plaka Vangjeli hapi portën e hyrjes së saj.

- Maria, - foli, - ndihmomë pak.

- Erdha, - tha ajo.

Besniku mbeti midis derës e korridorit. Zëri ishte i saj. Dhe ajo erdhi. Dera, gjysmë hapur, gjysmë e mbyllur. Plaka dhe karroca brenda saj, ai gjysmë brenda, gjysmë jashtë.

Te dera e korridorit ata panë sho-shoqin. Ajo me djalin në dorë, ai me zemrën në dorë.

- Merita, - tha ai.

- Besnik, - tha ajo.

Plaka Vangjeli shtyu karrocën, zgjati duart dhe mori djalin. Ata morën njëri- tjetrin. Lotët e atij pikonin mbi flokët e saj, lotët e asaj mbi gjirin e tij. Lotët e plakës njomnin doçkat e djalit, që përkëdhelnin fytyrën e rinuar të saj.

Ditë më vonë, Besniku, Merita, Ermiri dhe plaka Vangjeli morën rrugën për në Shqipëri. Ata të shuanin mallet e të putheshin me Varret, plaka të njihte të tjerë njerëz të mirë.